Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Bazuar në analizën e bërë për sasinë e letrës së konsumuar dhe informacionin mbi shpërndarjem respektive të letrës dhe pajisjeve, mund të themi se **sasia vjetore** e printimit dhe fotokopjimit të dokumentave nga punonjësit e administratës qendrore të shoqërisë "Albpetrol" sha është **mesatarisht 900,000 -950,000 printime A4/A3 bardh e zi dhe me ngjyra.**

1. Objektivi

Zhvillimi i tregut në Shqipëri ka mundësuar konkurimin në treg të shoqërive që ofrojnë realizimin e SPM-ve duke i ofruar pajisjet si me qira ashtu dhe me transferim pronësie (shitje). Gjithashtu zhvillimi i tregut ka bërë të mundur që shoqëritë tregtare të ofrojnë dhe paketa shërbimi për pajisjet e SMP-ve të tilla që mundësojnë mbulimin e të gjitha kostove variabël të përdorimit të tyre (bojë, toner, materiale të konsumueshme, shërbime pastrimi mirëmbajtjeje dhe riparimi) kundrejt një tarife për njësi printimi skanimit dhe fotokopjimit.

Duke u nisur nga analiza e ambientit të printimit të dokumentave në administratën e shoqërisë "Albpetrol" sha dhe mbështetur në mundësitë që ofrojnë zhvillimet e tregut, shoqëria do t'i japë zgjidhje problemeve administrative që lidhen me ambientin e printimit dhe përpunimit të dokumentave duke kaluar nga prokurimi dhe manaxhimi reaktiv dhe i veçuar i pajisjeve, materialeve të konsumit dhe shërbimeve për këto pajisje, në prokurimin e një sistemi të integruar dhe manaxhimit proaktiv të shërbimeve për printimin, skanimin dhe fotokopjimin e dokumentave teknike dhe shkresore (**Sistemi i Printimit të Menaxhuar SPM**) në përputhje me nevojën reale për këto shërbime, sipas volumit të punës që do të paraqitet dhe jo nëpërmjet planifikimit të pabazuar mbi nevojave për to.

Në këtë mënyrë shoqëria duhet të prokurorë një sistem të integruar, të manaxhueshëm dhe të monitorueshëm për printimin, skanimin dhe fotokopjimin e dokumentave që përpunohen nga punonjësit e administratës qendrore, duke përfshirë në këtë sistem edhe furnizimin me materiale

konsumi si dhe shërbimet për mirëmbajtjen, riparimin, monitorimin dhe manaxhimin proaktiv të këtyre pajisjeve gjatë gjithë periudhës së amortizimit teknologjik të tyre (1-4 vjet).

2. Përshkrimi i Sistemit të Printimit të Manaxhuar (SPM)

Sistemi i Printimit të Manaxhuar konsiston në furnizimin, instalimin, vënien në funksionim si dhe bashkëveprimin e koordinuar të tre komponentë të mëposhtëm:

- A. **Komponenti “Hardware”**, në të cilin përfshihen pajisjet për printimin, skanimin, fotokopjimin dhe shpërndarjen (fax, e-mail, shared folder) e dokumentave që nevojiten të angazhohen për ngritjen e SPM. Sasia dhe specifikimet për këto pajisje si dhe shpërndarja e tyre në përputhje me infrastrukturën dhe nevojat operacionale për shërbimet e kërkuara, janë përcaktuar në Aneksin I (Sasitë dhe specifikimet e pajisjeve të SMP).
- B. **Komponenti Shërbime**, në të cilin përfshihen shërbimet që do të kryen për furnizimin e pajisjeve me materiale konsumi (bojë, toner, pjesë ndërrimi), për pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të tyre, riparimin e pajisjeve që mund të paraqesin defekte si dhe zëvendësimin e përkoshëm të pajisjeve defektive me një pajisje të ngjashme duke mos shkakuar ndërprerjen e punës së punonjësve. Termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimit janë përcaktuar në Aneksin III (Kërkesat dhe kushtet për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit) bashkëlidhur këtij dokumenti.

Sistemi i Printimit të Manaxhuar duhet të sigurojë:

1. Realizimin pa ndërprerje dhe manaxhimin të proceseve të printimit, skanimit, fotokopjimit dhe shpërndarjes së dokumentave që përpunohen në kompani;
2. Rritjen e shkallës së utilizimit të pajisjeve që do të angazhohen në këtë sistem, me qëllim optimizimin e punës së pajisjeve, çlirimin e hapësirave në ambientet e punës si dhe uljen e kontrollin mbi kostot operacionale të pajisjeve;
3. Garantimin e një fleksibiliteti përdorimi të të gjitha pajisjeve duke i organizuar ato si një flotë, ku çdo punojës mund të aksesojë cilëndo pajisje që gjendet pranë vendit të tij të punës;
4. Të krijojë mundësi që pajisjet që do të jenë në përdorim të përbashkët dhe që do të vendosen në hollet e zyrave të jenë të aksesueshme nga punonjësit.
5. Të krijojë lehtësi për shpërndarjen e dokumentave që do të skanohen nga pajisjet e sistemit, duke i dërguar ato nga pajisja në destinacion (folder, e-mail, server etj).

4. Vlerësimi paraprak

Bazuar në analizën e bërë për sasinë e letrës së konsumuar dhe informacionin mbi shpërndarjen respektive të letrës dhe pajisjeve, **sasia vjetore** e printimit dhe fotokopjimit të dokumentave nga punonjësit e administratës qendrore të shoqërisë “Albeptrol” sha është **mesatarisht 920,000 printime A4/A3, bardh e zi dhe me ngjyra dhe paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:**

Emertimi			Sasia	Format
Shërbim	Printimi	Ngjyra	250,000	A4
Shërbim	Printimi	Bardh/Zi	650,000	A4
Shërbim	Printimi	Bardh/Zi	10,000	A3
Shërbim	Printimi	Ngjyra	10,000	A3

5. Prokurimi i zgjidhjes dhe vlerësimit të ofertave

Në mënyrë që të mundësohet përzgjedhja e sistemit më optimal për printimin, fotokopjimin dhe skanimin e dokumentave që përpunohen në zyrat qendrore të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. ofertat duhet të kenë një bazë krahasimi, përse i përket përfitimit ekonomik të shoqërisë. Prandaj është e nevojshme që ofertat të formulohen duke respektuar kriteret e mëposhtme:

1. Sistemi i ofruar duhet të mbulohet nga përgjegjësia e plotë e ofertuesit. Nën këtë model, shoqëria e përzgjedhur do të jetë përgjegjës për të gjitha aspektet e instalimit, konfigurimit, testimit, trajnimit të personelit të shoqërisë “Albpetrol” sha, si dhe për furnizimin me material konsumi, shërbimin dhe mirëmbajtjen e sistemit gjatë gjithë periudhës së kontratës.
2. Oferta do të konsiderohet si një i tërë, duke përfshirë si kostot për sigurimin e pajisjeve dhe programeve (qira për 1 vit) ashtu edhe kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me furnizimin dhe mirëfunksionimin e këtyre pajisjeve gjatë gjithë periudhës 1 vjeçare.
3. Oferta duhet të marrë parasysh që kohëzgjatja e kontratës do të konsiderohet periudha 1 vjeçare e amortizimit teknologjik të sistemit dhe pajisjeve të angazhuara
4. Vlera e ofertës me pajisjet e huazuara nga “Albpetrol” sha, oferta financiare, duhet të përfshijë:
 - a. **Vlerën e huazimit të pajisjeve** sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara, për të gjithë periudhën 1 vjeçare të kohëzgjatjes së kontratës, duke përfshirë në këtë vlerë të gjitha kostot për vënien në funksionim të sistemit (instalimin, konfigurimin, trajnimet, etj) si dhe kostot për riparimin (pjesë dhe punë) apo zëvendësimin e tyre në rast defektesh.
 - b. **Vlerën e huazimit të aplikimeve software** dhe utiliteteve të nevojshme për funksionimin dhe monitorimin e sistemit në përputhje me Kërkesat për kontrollin dhe monitorimin e Sistemit, ku duhet të jenë të përfshira të gjitha kostot që lidhen me licensat për përdoues apo me nevojat për përditësimet e nevojshme për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës
 - c. **Tarifën për çdo printim apo fotokopjim bardhë e zi e formatit A4**, pavarësisht nga pajisja që përdoret. Në këtë tarifë duhet të përfshihen të gjitha kostot për furnizimin me tonera ose bojë dhe materialet e tjera të konsumueshme si dhe kostot për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve, sipas kërkesave dhe kushteve për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit, përcaktuar në Aneksin 3.
 - d. **Tarifën për çdo printim apo fotokopjim me ngjyra e formatit A4**, pavarësisht nga pajisja që përdoret. Në këtë tarifë duhet të përfshihen të gjitha kostot për furnizimin me tonera ose bojë dhe materialet e tjera të konsumueshme si dhe kostot për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve, sipas kërkesave dhe kushteve për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit, përcaktuar në Aneksin 3.
 - e. **Tarifën për çdo printim apo fotokopjim bardhë e zi e formatit A3**, pavarësisht nga pajisja që përdoret. Në këtë tarifë duhet të përfshihen të gjitha kostot për furnizimin me tonera ose bojë dhe materialet e tjera të konsumueshme si dhe kostot për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve, sipas kërkesave dhe kushteve për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit, përcaktuar në Aneksin 3.
 - f. **Tarifën për çdo printim apo fotokopjim me ngjyra e formatit A3**, pavarësisht nga pajisja që përdoret. Në këtë tarifë duhet të përfshihen të gjitha kostot për furnizimin me tonera ose bojë dhe materialet e tjera të konsumueshme si dhe kostot për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve, sipas kërkesave dhe kushteve për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit, përcaktuar në Aneksin 3.
 - g. Ndryshimet mund të prekin nga njëra anë uljen e sasisë së printimit/fotokopjimit për shkak të rritjes së kontrollit dhe rritjes së shkallës së shkëmbimeve dixhitale dhe nga ana tjetër rritjen relative të sasisë së printimeve me ngjyra për shkak të disponueshmërisë më të madhe të pajisjeve me ngjyra që do të angazhohen dhe rritjen e kërkesave për cilësinë e dokumentave të printuara. Referuar specifikimit si më lart, Albpetrol sha mund të printojë një sasi më të ulët se ajo e parashikuar. Në këtë rast kontraktori nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbi sasinë e printuar më pak dhe as për fitimin e munguar

ANEKSI 1 – Nevojat dhe specifikimet e pajisjeve të SMP

3 pajisje -A4/A3 me shpjtesia te mesme me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:	590x675x965
Kapaciteti mbajtes i syrtareve, jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesit skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)
Shpejtesia e Skaimit SPDF :	120 ipm (simplex) / 240 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

5 pajisje -A4/3 me shpejtesi te mesme me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	350x495x505
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	100 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: ARDF	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)
Shpejtesia e Skanimit	30 ipm
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

10 pajisje -A4 me shpejtesi te mesme me keto specifikime:

Fotokopje/Printer/Skaner	
--------------------------	--

Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	480x445x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	200 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	1 - 2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm(duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

30 pajisje me ngjyra-A4 me keto specifikime

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra

Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	500x585x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	200 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	150 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2 pajisje me ngjyra-A4/A3 me keto specifikime

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra

Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	590x685x1210
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me e vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	200 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	110 ipm (simplex) / 180 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Kërkesa të përgjithshme për sistemin

- Pajisjet do të instalohen në ambientet e zyrave të administratës së “Albeptrol” sha sipas planvendosjes së tyre paraqitur në skicat e planimetrive për çdo kat të godinave.
- Pajisjet do të instalohen në rrjetin kompjuterik LAN të zyrave të “Albeptrol” sha të integruara me sistemet e tjera të manaxhimit të informacionit duke ofruar fleksibilitet të plotë për printimin, skanimin, fotokopjimin dhe shpërndarjen (fax, e-mail, shared folder) të dokumentave.
- Pajisjet duhet te implementohen brenda 30 ditësh nga firmosja e kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët ose broshurat për mallin që oferton.

ANEKSI 2 - Kërkesat për kontrollin dhe monitorimin e SMP

Në mënyrë që Sistemi i Printimit të Manaxhuar të jetë i kontrollueshëm dhe monitorueshëm, si lidhur me manaxhimin proaktiv të pajisjeve, ashtu edhe me mbikqyrjen për utilizimin dhe përdorimin e tyre, është e nevojshme që ky Sistem të monitorohet nëpërmjet aplikimeve Software që duhet të mundësojnë:

- Monitorimin i statusit të pajisjeve në kohe reale duke përdorur protocollet SNMP 1/2/3
- Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve në mënyrë të centralizuar. Krijimin e profileve të ndryshme të printimit, skanimit me anë të software dhe shpërndarjen e konfigurimit të të gjithë pajisjet, një grup apo disa pajisje në mënyrë automatike.
- Printim me element sigurie (duke venë kodin personal ose kartë) në secilën prej paisjeve në rrjet.
- Raportimin me email për sasine e printimeve të secilit përdorues (nëse aplikohet), të gjithë paisjeve apo një grupi të tyre.
- Menaxhimin e paisjeve me përdorues dhe konfigurimet përkatëse në mënyrë të centralizuar.
- Ruajtja e raporteve në server në mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
- Dërgimi i emaileve automatike në rast të shfaqjes së problemeve teknike.
- Dërgimi i emaileve automatike që tregojnë statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij në mënyrë proactive.
- Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilin përdorues, sektor, drejtori etj.
- Software-i duhet të ruajë në databazë të gjithë aktivitetin e pajisjes dhe të mundësojë krijimin e raporteve mbi bazë pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohën që pajisjet kanë ndënjur pa punë për arsye të problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohën e shfaqjes dhe zgjidhjes së një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës së problemit të shfaqur.
- Mundësimi për upgrade automatik me anë të software-ve të versioneve të fundit të firmwareve të pajisjeve.
- I gjithë sistemi duhet të jetë automatik dhe të monitorohet nga një qendër e vetme.

Kërkesa të përgjithshme për sistemin

- Sistemi duhet të ofrojë mundësi për monitorimin e gjendjes fizike, konsumimit dhe nevojës për një shërbim proaktiv të pajisjeve të angazhuara në SMP;
- Sistemi duhet të ofrojë mundësi për manaxhimin e tij në funksion të mbikqyrjes dhe kontrollit mbi shkallën e utilizimit dhe mënyrën e përdorimit të pajisjeve si dhe mbi optimizimin shpërndarjes së pajisjeve në përputhje me nevojat që do të paraqiten;
- Sistemi duhet të përfshijë edhe ato aplikime apo programe që facilitojnë shpërndarjen e dokumentave që përpunohen nëpërmjet fax, e-mail apo skedarëve të përbashkët në server-at e “Albpetrol” sha;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët ose broshurat për aplikimet dhe softwarët.
- Instalimi dhe konfigurimi i këtyre aplikimeve duhet të mbështetet me trajnimin e përdoruesve për funksionet bazë si dhe trajnimin e stafit teknik që do të bëjë administrimin, monitorimin dhe mbikqyrjen e sistemit
- Konfigurimi i sistemit duhet të kryhet brenda 30 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës dhe të jetë funksional përgjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës.
- Sistemi duhet të mundësojë konfigurime të ndryshme mbi pajisjet në mënyrë të centralizuar. Krijimin e një konfigurimi dhe dërgimin e tij në të gjitha pajisjet e tjera në mënyrë automatike.

-
- Sistemi duhet të mundësojë update për “firmware” të pajisjeve në mënyrë të centralizuar pa patur nevojën të behen një nga një dhe në mënyrë manuale.

Monitorimi i sistemit

Nga përdorimi i software mund të analizohet çdo operacion i printimit dhe monitorohet volumi i printimit për çdo përdorues, egziston mundësia e përditësimit të software nga versioni aktual në versionin e ardhshëm të platformës software-ike.

Siguria -në aspektin e sigurisë software duhet të manaxhojë karakteristikat e mëposhtme:

- Mbrojtja kundër përdorimit të paautorizuar të printimit;
- Ndarjen dhe administrimin e të drejtave të printimit për përdoruesit e ndryshëm, rolet apo departamentet.
- Vështrim i menjëhershëm se kush është duke shtypur, çfarë dokumenti dhe në cilën pajisje.

Monitorimi dhe Raportimi - në drejtim të monitorimit dhe raportimit software duhet të trajtojë specifikat e mëposhtme:

- Monitorimin e saktë për gjithë printimet, kopjimin dhe skanimin;
- Një raport standard, të lehtë për t’u lexuar me përmbledhje të bazuar në përdoruesit, sektorët, drejtoritë dhe projektet;
- Mundësinë për të krijuar raporte specifike duke ju përshtatur nevojave të ndryshme;
- Raporte automatike që mund të gjenerohen nga IT administratori dhe dërgohen në e- mail ose dosje në formatin e zgjedhur (html, xls, xml, CSV, PDF).

Menaxhimi i Printimit - në aspektin e menaxhimit të sistemit të printimit, sistemi duhet të ofrojë përfitimet e mëposhtme:

- Menaxhimin e shërbimit të printimit sipas kërkesave të institucionit, duke aktivizuar “rules&routing” për shërbimin mbi bazë përdoruesi, departamenti apo institucioni.
- Printimin, duke ju ofruar web faqes, me mundësi për të shtuar dhe fshirë printime të ndryshme;
- Printimin në shumë lloje paisjesh (follow me printing), duke i dhënë mundësi përdoruesit që puna e tij të mos ngecë në asnjë moment.
- Mundësi për vendosjen e kuotave të printimit për secilin përdorues.
- Të mundësojë lajmërimin e përdoruesve nëse arrihet apo tejkalohet kuota nga përdoruesi.

Menaxhimi i Scanimit - në aspektin e menaxhimit të sistemit të skanimit, sistemi duhet të ofrojë përfitimet e mëposhtme:

- Skanimin automatik me një klik të vetëm për përdoruesit dhe dërgimin e dosjes/ dokumentit në folder/e-mail;
- Përpunimin e dokumentit pas skanimit;
- Mundësinë e krijimit të një dokumenti të vetëm me shumë fletë të skanuara.

Në përgjithësi - sistemi duhet të mundësojë optimizimin në mënyra të ndryshme të trajtuara edhe më poshtë:

- Monitorimin e të shërbimeve të printimit në kuadër të kompanisë, nëpërmjet një web-faqe të vetme.
 - Centralizimin e mënyrave dhe karakteristikave të printimit;
 - Optimizimin e funksionimit të rrjetit;
 - Ofrimin e shërbimeve të printimit nga të gjitha vendet edhe në rast të dështimit të serverit qendror.
-

ANEKSI 3 - Kërkesat dhe kushtet për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit

Në këtë Aneks përfshihen termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve që do të kryen për furnizimin e pajisjeve me materiale konsumi (bojë, toner, pjesë ndërrimi), për pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të tyre, riparimin e pajisjeve që mund të paraqesin defekte si dhe zëvendësimin e përkohshëm të pajisjeve difektoze me një pajisje të ngjashme duke mos shkaktuar ndërprerjen e punës së punonjësve.

Pjesë e kontratës që do të angazhohet midis “Albperol” sha dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur do të jetë edhe Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit e cila do të mbulojë të gjithë kohëzgjatjen 1 vjeçare të kontratës .

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Sasitë e pajisjeve të printimit

Për të realizuar sistemin e shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen sasia e pajisjeve të mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Pajisje Multifunkionale bardhë e zi A3/A4, e madhe	3 copë
2	Pajisje Multifunkionale bardhë e zi A3/A4 standard	5 copë
3	Pajisje Multifunkionale bardh e zi A4	10 copë
4	Pajisje Multifunkionale me ngjyra A4	30 copë
5	Pajisje Multifunkionale me ngjyra A3/A4 e madhe	2 copë
	GJITHSEJ	50 copë

Afatet e ekzekutimit: Pajisjet e kërkuara si më sipër duhet të implementohen Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe shërbimi objekt prokurimi do të ekzekutohet 1 vit nga implementimi i pajisjeve.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Në këtë Aneks përfshihen termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve që do të kryen për furnizimin e pajisjeve me materiale konsumi (bojë, toner, pjesë ndërrimi), për pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të tyre, riparimin e pajisjeve që mund të paraqesin defekte si dhe zëvendësimin e përkohshëm të pajisjeve difektoze me një pajisje të ngjashme duke mos shkaktuar ndërprerjen e punës së punonjësve.

Pjesë e kontratës që do të angazhohet midis “Albperol” sha dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur do të jetë edhe Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit e cila do të mbulojë të gjithë kohëzgjatjen 1 vjeçare të kontratës.

MARRËVESHJA E NIVELIT TË SHËRBIMIT (SLA)

Përshkrimi i shërbimeve

1. Menaxhimi Pajisjeve

- Menaxhimi i pajisjeve është shërbimi i ofruar nga Kontraktuesi për të siguruar përdorimin efikas të pajisjeve te printimit.
- Kontraktori do të jetë përgjegjës për shërbimin periodik të mirëmbajtjes për pajisjet e ofruara, për të maksimizuar disponueshmërinë.
- Zëvendësimi i materialeve të konsumit, përveç tonerave, do të planifikohet në lidhje me shërbimet periodike të mirëmbajtjes së pajisjeve. Kontraktori do të jetë përgjegjës për sasinë e stokut për funksionimin e punës pa ndërpreje.
- Kontraktori do të krijojë një bazë të të dhënave të të gjitha pajisjeve të instaluar në ambientet e Klientit për të mbajtur të regjistruara performancën dhe disponueshmërinë e çdo pajisjeje.
- Sipas të dhënave të ofruara nga software-i i menaxhimit, kontraktori do të planifikojë dhe do të kryejë në kohën e duhur shërbimet periodike të mirëmbajtjes për çdo pajisje.
- Kontraktori do të vlerësojë performancën dhe mund të sugjerojë për përmirësimin e funksionimit, zgjerimin, përmirësimin ose heqjen e pajisjeve që synojnë rritjen e integritetit dhe produktivitetit me një përdorim efikas të bazuar në koston e çdo pajisje operationale, pa ndikuar mirëfunksionimin e punës.

2. Identifikimi i problemit dhe riparimi

- Kontraktori do të jetë përgjegjës për të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për identifikimin dhe riparimin e çdo problemi (mosfunksionim) të pajisjeve të printimit.
- Kontraktori do të jetë përgjegjës për zgjidhjen e çdo problemi që mund të ndodhë në pajisjet e printimit, me përjashtim të atyre problemeve që kanë të bëjnë me lidhjen e rrjetit, konfigurimin e software, i cili do të zgjidhet nga stafi i Klientit.
- Në rast të një difekti (mosfunksionim) të pranishëm në pajisjet e printimit, personeli klientit do të kontaktojë Help Desk të kontraktorit me e-mail, telefon apo celular dhe Kontraktori do të rivendosë funksionin e pajisjes,
- Për rivendosjen në funksionim të pajisjes apo funksioneve të sistemit, Kontraktori duhet të japë zgjidhjen në dy mënyra:

A Mbështetja Teknike

- Duke i siguruar klientit këshilla dhe instruksione për rivendosjen e funksionimit normal;
- Duke i dhënë informacion mbi shkaktuesit e mosfunksionimit dhe sugjerime për parandalimin e përsëritjes së tij.

B Shërbimi Teknik

- Duke suguruar ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes teknike në ambjentet e klientit nga stafi teknik i Kontraktorit;
- Duke siguruar heqjen e pajisjeve me difekt për t'u riparuar në servisin e kontraktorit, duke bërë zëvendësimin e përkohshëm të pajisjes me një tjetër.
- Për çdo problem të raportuar, personeli i kontraktorit do të hetojë dhe të kërkojë informacion në lidhje me veprimet që janë marrë në mënyrë për të zgjidhur problemin.
- Identifikimi i mosfunksionimit dhe vendosja në punë e shërbimit do të ofrohet nga kontraktori me një kohë minimale.

Mbështetja Teknike - për rreth 65% e problemeve do të sigurohet brenda pesë (24) orë pune.

Shërbimi Teknik - për rreth 35% e problemeve do të sigurohet brenda tetë (48) orë pune.

- Duke marrë parasysh peshën e problemit që mund të shkaktojnë vonesat e shërbimit, Kontraktori duhet të mbajë një sasi stok të pajisjeve të modeleve përkatëse të instaluara të cilat duhet të jenë të gatshme për përdorim të gjithë ose të pjesshëm.
- Kontraktori duhet të zëvendësojë përkohësisht çdo pajisje, e cila nuk mund të riparohet brenda kornizave kohore, me një të re që ka karakteristika të njëjta ose specifikime më të larta.

3. Menaxhimi i Konsumit

- Kontraktori do të jetë përgjegjës për furnizimin e vazhdueshëm të tonerave dhe materialeve të konsumueshme për pajisjet. Stoku i materialeve të konsumueshme duhet të përcaktohet për të pasur një furnizim të tyre dhe një ecuri të rregullt dhe pa ndërprerje të shërbimeve.
- Furnizimi me toner do të menaxhohet si procedurë më vete nga materialet e tjera të konsumueshme. Zëvendësimi i materialeve të konsumueshme (jo toner) do të jetë pjesë e Menaxhimit të Shërbimeve të Pajisjeve nga ana e Kontraktorit.
- Për të siguruar furnizimin e vazhdueshëm për toner, një sasi e mjaftueshme stok do të mbahet në magazinën e administratës së “Albpetrol” sha. Një toner shtesë për çdo lloj pajisje është kusht te jete ne ambjentet e “Albpetrol” sha për zëvendësim të menjëhershëm nga personeli i “Albpetrol”.
- Në thelb, pajisja duhet të dërgojë alert për përdoruesin kur toneri është gati të përfundojë. Në këtë moment personeli i klientit duhet të kontaktojë Help Desk të Kontraktorit për të bërë kërkesë për toner të ri. Kontraktori do të jetë përgjegjës për zëvendësimin e tonerit ose jep leje për përdorimin e tonerit shtesë nga rezervat, dhe zëvendësimin e tij me një tjetër.

4. Kontrolli dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara

- Personeli i Kontraktorit do të vlerësojë periodikisht të gjithë treguesit që tregojnë efikasitetin e punës të pajisjeve të vendosura dhe do të dorëzojë raport mujor mbi nivelin e shërbimit të ofruar në mënyrë për të parë ndryshime të mundshme që mund të realizohen. Raporti mujor të ketë kryesisht lidhje me:
 - Numrin e faqeve të printuara për çdo pajisje;
 - Notën e vlerësimit të pajisjeve;
 - Disponueshmërinë e pajisjeve dhe shërbimi i përfutur;
 - Kohën e nevojshme për të riparuar ndonjë dëmtim;
 - Disponueshmërinë e materialeve të konsumueshme.

Kërkesa të përgjithshme për shërbimin

- Kontraktori angazhohet për të ofruar këto shërbime për pajisjet dhe aplikimet software që do të angazhohen në bazë të ofertës për zgjidhjen e ofruar.
- Operatori ekonomik duhet të faktojë teknikisht si do mund të permbushë kriteret e SLA, në të kundert konsiderohet si kusht për skualifikim.
- Personeli i kontraktorit do të jetë përgjegjës për heqjen e materialeve të konsumueshme. Toneri i përdorur duhet të mbahet nga personeli i Klienti dhe Kontraktori do të ngarkohet me heqjen e këtyre materiale të konsumueshme, kur i zëvendëson ato më të reja.

-
- Çdo tre muaj do të ketë një takim midis përfaqësuesit të Klientit dhe përfaqësuesit të Kontraktorit për të vlerësuar performancën e kontratës. Çdo gjashtë muaj do të zhvillohet një studim për të parë plotësimin e kërkesave të përdoruesve nga pajisjet dhe shërbimet e ofruara nga Kontraktori.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

